



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1081/ 5 Prot.,

Datë 27.04.2026

V E N D I M
Nr. 556 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.04.2026 me

Objekt: Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6501, datë 08.04.2026 dhe me nr. 1081/2026 prot., datë 09.04.2026, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar, Shërbim*, me Nr. REF-80471-03-31-2026, me objekt “Shërbime mbështetëse për aktivitetin e çeljes së sezonit veror 2026”, me fond limit 6,866,667 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 14.04.2026, nga autoriteti kontraktor Bashkia Himarë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Think Advertising” ShPK, me Nipt L51315025S, Adresa: Rr: *Besim Alla, Pallati Noli nr.65, Garazhd kati (-1), Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Himarë.
Adresa: Rr. “25 Marsi”, Nr.2; Spile, Himarë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*” Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të*

Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Parapra

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes.

II.1. Në datën 02.04.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar, Shërbim*, me Nr. REF-80471-03-31-2026, me objekt “*Shërbime mbështetëse për aktivitetin e çeljes së sezonit veror 2026*”, me fond limit 6,866,667 Lekë pa TVSH parashikuar për t’u zhvilluar në datën 14.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

II.2. Njëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “*Think Advertising*” ShPK me numër ankimi elektronik A/2026/6501, datë 08.04.2026 dhe me nr. 1081/2026 prot., datë 09.04.2026, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Njëpërmjet shërbimit postar pranë Komisionit është administruar shkresa me datë 11.04.2026, “*Kërkesë për tërheqje nga ankesa*” e operatorit ekonomik “*Think Advertising*” ShPK protokolluar me nr. 1081/2 prot., datë 23.04.2026, me anë të së cilës ankimuesi kërkon:

Tërheqje nga ankesa e datës 09.04.2026, për procedurën me Nr. REF-80471-03-31-2026, me objekt “Shërbime mbështetëse për aktivitetin e çeljes së sezonit veror 2026”, me fond limit 6,866,667 Lek pa TVSH për t’u zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë, me argumentin; *“Pasi jemi te angazhuar në punë të tjera dhe e kemi të pamundur për vazhdimin e procedurave të ankimit ndaj tërhiqemi nga ankesa e depozituar në KPP.”*

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik “Think Advertising” ShPK, për tërheqje nga ankesa e datës 09.04.2026 nga KPP me numër ankimi elektronik A/2026/6501, datë 08.04.2026 dhe me nr. 1081/2026 prot., datë 09.04.2026, në lidhje me procedurën e prokurimit *“Procedurë e Hapur e Thjeshtuar, Shërbim, me Nr. REF-80471-03-31-2026, me objekt “Shërbime mbështetëse për aktivitetin e çeljes së sezonit veror 2026”, me fond limit 6,866,667 Lek pa TVSH parashikuar për t’u zhvilluar në datën 14.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në nenin 117 *“Tërheqja nga ankesa”* të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar parashikohet:

“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Në nenin 105 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, parashikohet: *“Operatori ekonomik ankimues ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar, në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Me paraqitjen e kërkesës për tërheqje, ndërpritet shqyrtimi i ankesës menjëherë. Për efekt të tarifës, ankesa konsiderohet si e mospranuar, dhe tarifa e ankesës nuk kthehet.”*

III.1.3. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimitin e tij.

Në këto kushte, për sa kohë që operatori ekonomik ankimues “Think Advertising” ShPK ka paraqitur kërkesë për ndërprerje të shqyrtimit të ankesës, me numër ankimi elektronik A/2026/6501, datë 08.04.2026 dhe me nr. 1081/2026 prot., datë 09.04.2026, dhe në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Komisioni i

Prokurimit Publik do të ndërpresë shqyrtimin e ankesën për procedurën e prokurimit objekt-ankimi “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar, Shërbim, me Nr. 80471-03-31-2026, me objekt “Shërbime mbështetëse për aktivitetin e çeljes së sezonit veror 2026”, me fond limit 6,866,667 Lek pa TVSH parashikuar për t’u zhvilluar në datën 14.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar, Shërbim, me Nr. REF-80471-03-31-2026, me objekt “Shërbime mbështetëse për aktivitetin e çeljes së sezonit veror 2026”, me fond limit 6,866,667 Lek pa TVSH parashikuar për t’u zhvilluar në datën 14.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.
2. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Think Advertising” ShPK.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Gjergj Mersini

Anëtar

Kreshnik Ternova

Nënkryetar

Fiorent Zguro

